



BULETIN INFORMATIV

KORRIK - SHTATOR 2025

Publikohet Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime

Në përmbushje të detyrimit ligjor si institucion publik i pavarur Komisioni Kombëtar Rregullator miratoi Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës 2024. Aty jepet një pasqyrë e zhvillimit të sektorit UK dhe vlerësimit të performancës për secilën shoqëri UK, krahasuar me vitin paraardhës (benchmarking) duke shërbyer gjithashtu si instrument transparence dhe informimi publik për të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e ujit. Viti 2024 konsiderohet si viti i dytë i implementimit të reformës në sektorin e ujit në Shqipëri, ku deri në mbyllje të vitit janë krijuar 14 shoqëri rajonale UK, nga 15 të planifikuara sipas reformës. Ndërkohë, në sektor vazhdojnë të operojnë 3 shoqëri UK ekzistuese si SHUK Tiranë, Kamëz dhe Vorë. Reforma në sektorin UK gjatë vitit 2024, ka dhënë ndikim pozitiv, duke çuar në përmirësim të ndjeshëm në shumicën e treguesve të performancës, veçanërisht në gjendjen financiare të sektorit, në krahasim me vitin paraardhës, i cili përbënte një ndër objektivat kryesorë të reformës dhe të Strategjisë Sektoriale Kombëtare 2023-2030. Mbulimet e Kostove Totale dhe ato O&M kanë një përmirësim të ndjeshëm, ndërsa Norma e Arkëtimit Korente është përmirësuar me 0.7%. Përmirësimi i treguesit të Kostove O&M, vjen kryesisht si rezultat i uljes së disa prej kostove, me përjashtim të kostove të punës. Ndikimin kryesor e japin reduktimi i kostove të materialeve kimikate, duke vijuar më tej me kostot e karburanteve, kostot e tjera operacionale si dhe kostot e shërbimeve të nënkontraktuara. Gjithashtu edhe mbulimi i Kostove Totale ka rritje si pasojë e uljes së kostove të amortizimit dhe interesat & principalet. Treguesit e tjetër të përmirësuar për vitin 2024 lidhen direkt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimit më të mirë të shoqërive UK. [Raporti i plotë](#)

PËRMBAJTJA

- RAPORTI I PERFORMANCËS
- VENDIMMARRJA E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
- PJESËMARRJA NË KONFERENCA



VENDIMARRJA E KKRR

Në tre mujorin e tretë të vitit 2025, nga muaji korrik deri në muajin shtator, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU ka zhvilluar disa mbledhje, në të cilat ka miratuar vendime, midis të cilëve veçohen:

- ✓ Vendim “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a”
- ✓ Vendim “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë sh.a”
- ✓ Vendim “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sh.a”
- ✓ Vendim “Për shtyrjen e afatit të plotësimit të dokumentacionit në procedurën e aplikimit për nivel të ri tarifar për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë sh.a”
- ✓ Vendim “Për miratimin e Raportit Vjetor të Performancës së Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime për vitin 2024”
- ✓ Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr.2, datë 13.01.2025 “Për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2025”

LICENCA

Në sektorin e ujit operojnë aktualisht 17 shoqëri ujësjiellës kanalizime, 14 prej të cilave të licencuara si shoqëri rajonale: Shoqëria Rajonale UK Durrës, Lezhë, Korçë, Kukës, Gjirokastrë, Berat, Fier, Lushnjë, Pogradec, Elbasan, Sarandë, Dibër, Shkodër, Vlorë dhe 3 shoqëri të tjera UK: Tiranë, Vorë, Kamëz. situata mbetet e njëjtë, pasi edhe përgjatë tre mujorit të tretë të vitit aktual, ERRU nuk ka patur asnjë vendimmarrje në lidhje me licencimin e shoqërive Rajonale Ujësjiellës Kanalizime apo tre shoqërive të tjera ujësjiellëse.

TARIFA

Në 3-mujorin e tretë të vitit 2025, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) ka miratuar tarifat e shërbimit UK për tre shoqëri: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë dhe Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan. Ndërkohë që ka shtyrë afatin e aplikimit për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a. Miratimi i propozimeve të ardhura nga këto shoqëri e çon në nëntë numrin e shoqërive rajonale që operojnë me tarifa të reja që pas reformimit të sektorit të ujit, të nisur në fillim të vitit 2022.

ERRU në seminarin rajonal për rregullimin e shërbimeve të ujit në rajonin e Danubit

Më 24 – 26 shtator, Enti Rregullator i Ujit mori pjesë në seminarin rajonal mbi rregullimin e shërbimeve të ujit në Rajonin e Danubit, i mbajtur në Robert Schuman Centre, Villa Schifanoia – Firenze, në bashkorganizimin e World Bank Danube Water Program, WAREG – Rrjeti Evropian i Rregullatorëve të Ujit dhe Florence School of Regulation. Seminari mbledhi rregullatorë dhe ekspertë të sektorit nga vendet e rajonit, duke krijuar një platformë për shkëmbim përvojash, diskutim mbi sfidat rregullatore dhe forcim të bashkëpunimit rajonal. Ky aktivitet u shoqërua edhe me sesione trajnimi nga ekspertë



ndërkombëtarë të njohur, duke e kthyer Firencen në një qendër të shkëmbimit të njohurive dhe përvojave mbi rregullimin e shërbimeve të ujit. Pjesëmarrja e ERRU-së në këtë seminar thekson angazhimin e institucionit për të forcuar kapacitetet rregullatore, për të ndjekur standardet më të mira evropiane dhe për të kontribuar në zhvillimin e sektorit të ujit në Shqipëri.

“Israel-Albania Watt & Water Energy Conference”



Në fillim të muajit korrik, ERRU mori pjesë në konferencën ndërkombëtare “Israel-Albania Watt & Water Energy Conference” zhvilluar në Tiranë, ku u mbledhën institucione dhe përfaqësues të sektorëve të energjisë dhe ujit nga Shqipëria dhe Izraeli. Përmes pjesëmarrjes në sesione teknike dhe takime dypalëshe (B2B), ERRU kontriboi në diskutimet mbi sfidat aktuale të sektorit dhe nevojën për shkëmbim përvojash e forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Qasja ndaj modeleve të suksesshme të menaxhimit të ujit dhe përmirësimit të praktikave rregullatore ishin në fokus të angazhimit tonë në këtë event. Kjo përfshirje është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të ERRU për të ndërtuar partneritete të dobishme dhe për të sjellë standarde më të larta në shërbim të sektorit të ujit në Shqipëri.

Workshop mbi forcimin e monitorimit dhe raportimit për ITUN

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, GIZ dhe AKUK organizuan workshopin: “Forcimi i sistemeve të monitorimit dhe raportimit për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri”. ERRU kontriboi në seminar me një prezantim mbi standardet e performancës dhe kërkesat për të dhënat për ujërat e ndotura, përfshi ITUN, duke theksuar rëndësinë e vendosjes së indikatorëve të qartë dhe praktikave të unifikuara për monitorimin dhe raportimin e performancës së shoqërive UK. Pjesëmarrja e ERRU nënvizoi rolin e tij kyç në: forcimin e sistemeve të monitorimit; garantimin e standardeve të performancës



dhe avancimin e bashkëpunimit institucional në sektorin e ujit. ERRU mbetet e angazhuar për të garantuar shërbime të qëndrueshme dhe mbrojtje të mjedisit në interes të qytetarëve.

